



## SYLLABUSI I LËNDËS “METODAT E TRANSMETIMIT”

Të dhëna bazike të lëndës			
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike		
<b>Titulli i lëndës:</b>	Metodat e transmetimit		
<b>Programi:</b>	Teknologjitë e Informacionit dhe Telekomunikimi		
<b>Niveli:</b>	Baçelor		
<b>Statusi lëndës:</b>	Obligative		
<b>Viti i studimeve:</b>	2		
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2+2 (ligjërata dhe ushtrime)		
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	6 ECTS		
<b>Koha / lokacioni:</b>	Të publikuara në web site të universitetit!		
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	Ass. Betim Maloku, Ph. D. c.		
<b>Të dhënat kontaktuese:</b>	betim.maloku@uni-prizren.com		
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	Lënda ofron koncepte bazë rreth metodave të ndryshme të transmetimit, duke përfshirë modelet e rrjeteve, të dhënat dhe sinjalet, transmetimin digjital e analog, multipleksimin, shpërndarjen e spektrit, mediumet transmetuese, komutimin, qasjen e shumëfishtë, standardet Ethernet dhe pa tel, etj.		
<b>Qëllimi i lëndës:</b>	Qëllimi i kësaj lëndë është që t’iu japë studentëve njohuri të përgjithshme rreth: <ul style="list-style-type: none"><li>• Teknikave aktuale të transmetimit të sinjalit;</li><li>• Strukturës kryesore të sistemeve të komunikimit;</li><li>• Sinjaleve në kohë të vazhdueshme / kohë diskrete;</li><li>• Spektrit;</li><li>• Sistemeve lineare me kohë të pandryshueshme;</li><li>• Përgjigjesit frekuencore;</li><li>• Nivelit;</li><li>• Sinjaleve ndërhyrëse;</li><li>• Kapacitetit të kanalit.</li></ul>		
<b>Rezultatet e të nxënit:</b>	Studenti do të jetë në gjendje të kuptojë rreth: <ul style="list-style-type: none"><li>• Interferencës ndërmjetë simboleve;</li><li>• Transmetimit të sinjalit ultë / brez kalues;</li><li>• Kodeve të linjës;</li><li>• Teknikave të modulimit dixhital (FSK, QAM, PSK, OFDM);</li><li>• Teknikave të aksesit të shumëfishtë (TDMA, CDMA, FDMA, SDMA);</li><li>• Bazave të komutimit të qarkut dhe komutimit të paketave.</li></ul>		
<b>Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	2	2



Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në terren	1	1	1
Kollokfiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	2	4
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10	30
Përgatitja përfundimtare për provim	5	6	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	3	6
Projektet, prezantimet, etj	4	2	8
<b>Totali</b>			<b>150 orë (6 ECTS)</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Lënda është kombinim i ligjëratave, diskutimeve, ushtrimeve numerike dhe laboratorike, ndërsa detyrat prezantohen nga mësimdhënësi në laborator.		
<b>Metodologjia e vlerësimit:</b>	Vijueshmëria në ligjërata dhe ushtrime: 5% + 5%. Projekti: 10% Testi 1: 40%. Testi 2: 40%. Ose provimi përfundimtar: 100%.		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura primare:</b>	1. Behrouz A. Forouzan, “Data Communications and Networking”, McGraw-Hill.		
<b>Literatura shtesë:</b>	2. I.A. Glover, P.M. Grant, “Digital Communications”, Prentice Hall. 3. Tarmo Anttalainen, “Introduction to Telecommunications Engineering”, Artech House. 4. Leon W. Couch, “Digital and Analog Communication Systems”, Pearson Prentice Hall.		

<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>		
<b>Java</b>	<b>Ligjërata</b>	<b>Ushtrime</b>
<i>Java e parë:</i>	Hyrje Prezantimi i syllabusit	Hyrje Prezantimi i syllabusit
<i>Java e dytë:</i>	Modelet e rrjeteve	Modelet e rrjeteve
<i>Java e tretë:</i>	Të dhënat dhe sinjalet -1	Të dhënat dhe sinjalet -1
<i>Java e katërt:</i>	Të dhënat dhe sinjalet -2	Të dhënat dhe sinjalet -2
<i>Java e pestë:</i>	Transmetimi digjital	Transmetimi digjital
<i>Java e gjashtë:</i>	Transmetimi analog	Transmetimi analog
<i>Java e shtatë:</i>	Multipleksimi dhe përhapja	Multipleksimi dhe përhapja
<i>Java e tetë:</i>	Testi 1	Testi 1
<i>Java e nëntë:</i>	Mediumet transmetuese	Mediumet transmetuese
<i>Java e dhjetë:</i>	Komutimi	Komutimi



<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Qasja e shumëfishtë	Qasja e shumëfishtë
<i>Java e dybëdhjetë:</i>	LAN-et e telëzuara: Etherneti	LAN-et e telëzuara: Etherneti
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	LAN-et e patelëzuara	LAN-et e patelëzuara
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Lidhja e LAN-eve, rrjeteve kurrizore (kryesore) dhe LAN-eve virtuale	Lidhja e LAN-eve, rrjeteve kurrizore (kryesore) dhe LAN-eve virtuale
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Testi 2	Testi 2
<b>Politikat akademike dhe kodi i sjelljes</b>		
<ul style="list-style-type: none"><li>• Në përgjithësi prezantimet e ligjëratave do të bëhen përmes MS PowerPoint, tabelës, përdorimit të materialeve, programeve kompjuterike dhe ushtrimeve numerike.</li><li>• Po ashtu, nga mësimdhënësit do të sigurohen edhe materiale tjera shtesë (punime shkencore, publikime, buletinet nacionale, si dhe zbulimet dhe hulumtimet e fundit).</li><li>• Në mungesë të mundësisë që puna praktike të organizohet çdo javë, në bashkëpunim me menaxhmentin e universitetit, ky aktivitet do të organizohet në ditë të caktuara në: organizata, kompani, njësitë prodhuese-përpunuese, etj.</li><li>• Gjatë çdo seancë do të organizohet qasja e bashkëbisedimit dhe bashkëparticipimit me studentë!</li><li>• Nga studentët kërkohet që të jenë të rregullt në ligjëratat dhe ushtrimet!</li><li>• Do të vlerësohet kontributi i studentëve kur ata bashkëpunojnë dhe participojnë në ligjëratat dhe ushtrimet e lëndës!</li><li>• Ardhja e studentëve me kohë në ligjëratat dhe ushtrimet është e obligueshme!</li></ul>		